



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 11241-01905-00-2015 i Regjistrit. Themeltar
Nr. 00 - 2022 - 3860 i Vendimit (545)**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|---------------------|-------------------|
| Artur KALAJA | - Kryesues |
| Ervin PUPE | - Anëtar |
| Albana BOKSI | - Anëtare |

sot më datë 14.12.2022, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen gjyqësore me nr. 11241-01905-00-2015 akti regjistri, që ka lidhje me shqyrtimin e çështjes që ju përket këtyre palëve:

PADITËS: Adriatik Kaja.

TË PADITUR: Komunitetit Mysliman i Shqipërisë.
Komuniteti Myslyman - Myftinia e Durrësit.

OBJEKTI: 1-Deklarimin e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.
2-Detyrimi i Komunitetit Myslyman, Myftinia Durrës, të më paguajë dëmshpërblim sa paga e një viti, shpërblimin për vjetërsinë si dhe pagesën për pushimet vjetore.
3-Pagimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore përfshirë dhe pagën e avokatit nga Komuniteti Myslyman Myftinia Durrës.

BAZA LIGJORE: Neni 32 e 106 të K.Pr.Civile, nenet 143,145,155 e vijues të ligjit nr. 7961, datë 132.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SE LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Artur Kalaja mbi rekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse, në këtë gjykim, kundër vendimit nr.10-2015-698 (278), datë 30.03.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes.

1. Padiësi Adriatik Kaja ka punuar pranë palës së paditur Komunitetit Mysliman - Myftinia Durrës, me detyrën si menaxher dhe administratori i pronave të Komunitetit Mysliman, gjatë periudhës 01.09.2004 deri 20.09.2010.

2. Marrëdhënia juridike midis palës paditëse dhe palës së paditur është formalizuar nëpërmjet kontratës me afat të pacaktuar, të nënshkruar më datë 01.09.2004. Në nënshkrimin e kësaj kontrate Komuniteti Mysliman-Myftinia Durrës është përfaqësuar nga Myftiu i Durrësit Ilir Ali Vokshi.

Rezulton se me shkresën nr.369, datë 08.09.2004, padiësi është njoftuar nga Kryetari i Komunitetit Myslyman se Kryesia e Komunitetit Myslyman me vendimin nr.22, datë 08.09.2004, ka emëruar z.Adriatik Kaja si menaxher të Myftinisë Durrës, duke filluar marrëdhëniet nga data 01.09.2004.

Po kështu, me vërtetimin nr.10 prot., datë 30.09.2010 të Komunitetit Mysliman – Myftinia e Rrethit Durrës vërtetohet se Adriatik Kaja ka filluar punë me detyrën menaxher me datë 01.09.2004 deri më datë 01.08.2007 dhe nga data 01.08.2007 deri më datën 20.09.2010 ka punuar si administrator, menaxher. I njëjti fakt rezulton edhe nga kopja e librezës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me numër serie 0494872 në emër të padiësit Adriatik Kaja me numër sigurimi shoqëror H20601268M, ku rezulton derdhja e kontributit në emër të padiësit nga viti 2004 deri në vitin 2010.

3. Nga ana tjetër, me shkresën nr.384/4, datë 21.09.2010, të Komunitetit Mysliman, nënshkruar nga kryetari H.Selim Muça, padiësi Adriatik Kaja njoftohet se: “Kryesia e Komunitetit Mysliman në mbledhjen e saj të radhës me vendimin nr.15, datë 20.09.2010, ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra e administratorit të Myftinisë Durrës.”

Duke mos qenë dakord me këtë ndërprerje të kontratës së punës, padiësi Adriatik Kaja i është drejtuar gjykatës me padinë për të zgjidhur gjyqësisht pasojat e largimit nga puna.

4. Pala e paditur Komuniteti Mysliman-Myftinia Durrës ka depozituar në sekretarinë gjyqësore jashtëgjyqësisht kërkesën nr. 99, datë 26.01.2011, ku kërkoi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke parashtruar se: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë funksionon në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 për organizatat jo fitimprurëse dhe rregullores së brendshme të komunitetit të miratuar me datën 14.05.2005, i cili rregullon edhe marrëdhëniet e ndërsjella midis Komunitetit dhe Myftinisë Durrës.

Bazuar në nenet 59 e 60 të Statutit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) dhe nenet 134 e 138 e vijues të rregullores së brendshme padiësi (dhënia e masave disiplinore) ka qenë i detyruar të ndjekë rrugën e ankimit administrativ gjë që nuk e ka bërë.

5. Fillimisht, lidhur me kërkesën si më sipër, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 24.02.2011**, ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës së palës së paditur Komuniteti Mysliman Myftinia Durrës për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjes civile nr. 21237-03814 (646/3796), datë 15.10.2010 si të pabazuar në ligj”.

6. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka ushtruar **ankim të veçantë** pala e paditur komuniteti Myslyman-Myftinia Durrës.

7.Në këto kushte, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 29.03.2011**, ka vendosur:

“Pezullimin e gjykimit të çështjes civile nr. 21337-03814 (646/3796), datë 15.10.2010, derisa Gjykata e Lartë të shprehet për ankimin e palës së paditur Komuniteti Myslyman-Myftynia Durrës”.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2012-1187 (241) datë 10.05.2012, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit datë 24.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”

9. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 11-2013-669 (343), datë 07.02.2013, ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Adriatik Laja me të paditur Komuniteti Mysliman – Myftynia Durrës me objekt: “Deklarimi i zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimi i Komuniteti Mysliman, Myftynia Durrës, të më paguaj dëmshpërblim sa paga e një vitit, shpërblimin për vjetërsinë...”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, arsyeton se: “...Në përfundim të shqyrtimit të pretendimit të palëve ndërgjyqëse dhe provave të paraqitura prej tyre gjykata çmon se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet të rrëzohet. Nga shqyrtimi i akteve shkresore rezulton se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune pranë palës së paditur Komuniteti Mysliman – Myftynia Durrës për periudhën e pretenduar, fakt që provohet me provat shkresore të administruara në gjykim... Në këtë këndvështrim duke qenë se marrëdhëniet e punës është e provuar dhe u pohua në seancë edhe nga përfaqësuesit e të paditurve nuk ka vend për të analizuar pretendimet kontradiktore të palës së paditur në lidhje me ekzistencën e aktit të shkruar, kontratës së punës që është paraqitur si provë në gjykim.

Nga ana tjetër nga analiza e fakteve dhe rrethanave rezulton se në lidhje me përfundimin e marrëdhënies të punës ka një vendim të kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar, e cila i është komunikuar paditësit me shkrim... Sa i takon procedurën së largimit nga puna gjykata çmon se ajo nuk është respektuar nga pala e paditur. Nuk u paraqitën në gjykim prova me të cilat të provohet se pala e paditur e ka njoftuar paditësin për nisjen e procedurave të largimit nga puna, ta ketë thirrur atë në takim dhe ti ketë komunikuar shkaqet që sipas saj nuk lejojnë vazhdimin e mëtejshëm të marrëdhënies së punës... Në lidhje me afatin e njoftimit rezulton nga provat shkresore dhe konkretisht nga librezat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore e paraqitur si provë në gjykim se paditësi është në marrëdhënie pune me palën e paditur prej më shumë se 7 vjetësh. Në këto kushte gjykata çmon se nuk janë respektuar afatet e parashikuara nga neni 143 i K.Punës... Afati i lajmërimit të paditësit për ndërprerjen e marrëdhënies të punës duhet të ishte 3 muaj dhe në kushtet e ndryshimeve të tyre me kontratë jo më pak se një muaj, meqenëse paditësi ka më shumë se 6 muaj punë pranë palës së paditur. Nuk ka parashikime të ndryshme nga palët për afatet e mësipërme sikundër parashikon neni 144/2, por konstatohet se edhe në kontratën e punës në pikën “Zgjidhja e kontratës” palët nuk kanë parashikuar afate siç parashikohen në nenin 143 të K.Punës. Rezulton pra se ky afat nuk është respektuar nga pala e paditur.

...Nga provat e paraqitura në gjykim vlerësohet se paditësi nëpërmjet veprimeve të tij ka shkelur me faj të rëndë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga kontrata e punës dhe që kanë të bëjnë me administrimin e vlerave materiale dhe monetare të palës së paditur. Shkelja shkon deri në mungesën e vlerave të konsiderueshme monetare të cilat kanë rezultuar nga kontrollat e ushtruara dhe pavarësisht se si do të përfundojë çështja civile (e cila ngarkon me përgjegjësi monetare paditësin dhe shtetasin Ilir Vokshi) duke qenë se jemi para një vendimi që nuk ka marrë formë të prerë, mjafton konstatimi i kontrollit financiar për të arritur në konkluzionin se

me veprimet e tij paditësi ka kryer shkelje të tilla të cilat shkelin parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës. Në kushtet kur ka akte shkresore që provojnë shpërdorimin e pasurisë së palës së paditur nuk mund ti kërkohet kësaj të fundit të vazhdojë marrëdhënia kontraktuale e punës apo shpërblimi për shkak të ndërprerjes së kësaj marrëdhënie për shkak se kjo ndërprerje është e justifikuar. Edhe sikur kërkimet ndaj paditësit për mungesën e vlerave monetare të mos provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, provohet fakti se ai ka lëvruar shuma monetare në persona të pa licencuar për të kryer veprimtari ndërtimore, ka lëvruar shuma të konsiderueshme pa bërë pasqyrimin në arkën e palës së paditur gjë që ka shkaktuar humbjen e besimit të të paditurve ndaj tij dhe përbëjnë përsëri shkelje të rënda në kuptim të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e paditësit si administrator i pasurive të palës së paditur. Në rrethanat e mësipërme sipas parashikimeve të nenit 154 pika “3” gjykata vendos që pavarësisht konstatimit se nuk është respektuar procedura e largimit nga puna punëdhënësi nuk duhet ta paguajë këtë shpërblim. Meqenëse arrin në përfundimin se padia është e pabazuar dhe duhet të rrezohet sipas përcaktimeve të nenit 106 e vijues të K.Pr.Civile shpenzimet gjyqësore duhet të lihen në ngarkim të palës paditëse...”

10. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur ankim pala paditëse Adriatik Kaja, duke parashtruar shkaqet (ndër të tjera) se:

- Nuk është respektuar afati i njoftimit për procedurën e largimit nga puna, nga nenet 143 e 144 të K.Punës. Afati i njoftimit sipas kodit të Punës dhe kohëzgjatjes së marrëdhënies të punës, që kanë qenë më shumë se 7 vjet, duhet të ishte 3 muaj.
- Nuk u paraqitën në gjykim prova që të vërtetonin se pala e paditur e ka njoftuar paditësin për nisjen e procedurave të largimit nga puna, ta ketë thirrur në takim, apo ti ketë komunikuar shkaqet që nuk lejonin vazhdimin e marrëdhënies të punës.
- Nuk është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës sipas nenit 144 të K.Punës.
- Pushimin nga puna e konsideroj si zgjidhje menjëhershme dhe pa asnjë shkak të justifikuar të kontratës së punës. Në largimin tim nga puna, në shkresën nr. 384/4 dt.21.09.2010 të Komunitetit Mysliman, për largimin tim nga puna nuk është formuluar asnjë shkak.
- Gjykata në pjesën arsyetuese të vendimit i referohet një procesi tjetër gjyqësor, i cili ka filluar muaj më vonë në krahasim me procesin objekt ankimi, dhe nuk kishte asnjë provë që kishte lidhje me kohën kur jam larguar nga puna.
- Nuk kam pasur asnjë vërejtje apo masë disiplinore të dhënë nga punëdhënësi.
- Kështu del që Gjykata ka paragjykuar çështjen dhe procesin dhe nuk është bazuar në provat që kishte në dispozicion, duke u rreshtuar hapur me njërin palë.

11. Pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-698 (278), datë 30.03.2015, ka vendosur:

“Lëniën në fuqi të vendimit civil nr.11-2013-669 (343), datë 07.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me këtë ndryshim:

Shpërblimin e paditësit Adriatik Kaja me 3 (tre) paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në shkelje të afatit të njoftimit, nga pala e paditur.

Shpërblimin e paditësit Adriatik Kaja me 2 (dy) paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në shkelje të procedurës.

Shpenzimet gjyqësore përcaktohen në masën 50% me 50% për secilin nga palët ndërgjyqëse.”

Gjykata e Apelit Durrës arsyeton se: “...Kjo gjykatë vlerëson se drejtë ka parashtruar rrethanat e çështjes, gjykata e shkallës së parë. Drejtë është konkluduar edhe në përfundimin se kontrata e punës së paditësit Adriatik Kaja është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara nga pala e paditur, (si punëdhënës). Paditësi Adriatik Kaja rezulton të ketë pasur kontratë individuale pune me palën e paditur, për një kohëzgjatje pa afat të përcaktuar, (kontratë të datës 01.09.2004).

Lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës me palë ato ndërgjyqësore, “me“ ose “pa“ shkaqe të arsyeshme kjo gjykatë vlerëson se: në vështrim të rrethanave dhe fakteve të paraqitura nga pala e paditur si shkak për zgjidhjen e kontratës së punës me paditësin është parashtruar “rrethanat e rënda të cilat nuk lejojnë vazhdimin e kontratës së punës, sipas parimit të mirëbesimit“, kjo gjykatë vlerëson se ashtu sikurse arsyeton gjykata e shkallës së parë, ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës me paditësin. Administrimi i keq i vlerave materiale dhe monetare nga paditësi Adriatik, në dëm të punëdhënësit, ka sjellë shkeljen e parimit të mirëbesimit në marrëdhënien e punës si dhe lejon punëdhënësin të konsideroj këto veprime si shkelje të detyrimeve kontraktuale me faj të rëndë nga punëmarrësi...

Lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës me efekt të menjëhershëm “duke “ ose “pa“ respektuar afati i njoftimit tre mujor kjo gjykatë vlerëson se :.. Në rastin konkret pala paditëse ka qenë e punësuar pranë palës së paditur nga data 01.09.2004 (deri më 20.09.2010), pra për më shumë se pesë vjet. Në këto kushte pala e paditur nuk e ka respektuar afatin 3 mujor të njoftimit të palës paditëse për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, e për pasojë bazuar në paragrafin 4 të nenit 143 K.Punës, kjo zgjidhje e kontratës së punës trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm.

Sipas nenit 144.5/1 të po këtij Kodi, ana e paditur, punëdhënësi, ka pasur barrën e provës të vërtetojë që procedura e përcaktuar në këtë dispozitë është respektuar. Por për rastin në shqyrtim nuk rezulton e vërtetuar që ana e paditur të ketë respektuar procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës. Në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë akt që pala e paditur të ketë njoftuar me shkrim të paktën 72 orë më parë punëmarrësin, paditësin, se do të realizojë takim për të biseduar me të dhe për t’i parashtruar asaj arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë, duke i dhënë mundësinë që edhe punëmarrësja të shprehej në lidhje me vendimin e anës së paditur. Gjithashtu nuk rezulton e vërtetuar që ana e paditur të ketë njoftuar me shkrim paditësin, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në kushtet kur pala e paditur ka zgjidhur kontratën e punës pa respektuar afatin e njoftimit, sipas paragrafit të 4 të kësaj dispozitës, zgjidhja e kontratës “trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm”, dhe për pasojë bazuar në paragrafin e pestë të këtij neni, duhet që punëdhënësi ti japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy muajsh pagë që i shtohen dëmshpërblimeve të tjera të mundshme.

Për sa më sipër kjo gjykatë vlerëson se jemi përpara zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme e të justifikuar nga punëdhënësi, duke sjellë në vëmendje dhe në vlerësim të gjykatës, pretendimet e palëve, dhe në humbje të së drejtës së punëmarrësit për shpërblimin për vjetërsi, (referuar nenit 154/4 të K.Punës). Kjo gjykatë duke vlerësuar shkallën e fajit të kryer nga punëmarrësi në detyrimin kontrator, si dhe mosrespektimin e procedurës formale të zgjidhjes së kontratës nga punëdhënësi të parashikuar në nenin 144 të K.Punës, konkludon se punëmarrësi duhet të dëmshpërblehet vetëm për dy kërkime të saj, në atë për afatin e njoftimit si dhe për zgjidhje të kontratës së punës në shkelje të procedurës...”.

12. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka paraqitur rekurs pala paditëse Adriatik Kaja më datë 28.04.2015 dhe pala e paditur Komuniteti Myslyman-Myftinia Durrës më datë 23.04.2015.

Rekursi i palës paditëse Adriatik Kaja.

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është dhënë në shkelje të hapur të parimit të një procesi të drejtë, të paanshëm dhe të bazuar në ligj, si dhe duke mos respektuar dhe zbatuar drejt ligjin material e procedural, për pasojë na duket i kundraligjshëm, për pasojë brenda afatit ligjor, e kundërshtojmë vetëm në lidhje me pjesën për të cilën është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë.
- Jam larguar nga puna pa ndonjë shkak të pretenduar nga i padituri: Në proces nuk është paraqitur asnjë provë për të treguar se janë respektuar procedurat e largimit nga puna. Në asnjë dokument të largimit tim nga puna nuk është paraqitur ndonjë pretendim në lidhje me këtë largim nga i padituri.
- Gjykata e Apelit Durrës (njësoj si Gjykata e Shkallës së Parë) ka shkelur ligjin pasi ka bërë interpretim të gabuar të ligjit. Gjykata e Apelit Durrës në mënyrë absurde ka dhënë arsyetime në kundërshtim me K.Pr.Civile dhe problemi i cili duhet të trajtohet dhe zgjidhur është nëse si provë për të provuar shkakun konsiderohet vendimi i një procesi gjyqësor në vazhdim apo vendimi përfundimtar i konfliktit gjyqësor.
- Gjykata e Apelit Durrës, njësoj si Gjykata e Shkallës së Parë, duke bërë kalime logjike interpretuese jo të barasvlefshme ka arritur në përfundime të cilat nuk përputhen dhe ndryshojnë tërësisht nga provat dhe baza ligjore të përdorur në fillim të arsyetimit dhe konkretisht: Gjykata pretendon se jam larguar nga puna për shkaqe të justifikuara, kur në asnjë rast vetë i padituri nuk e ka pretenduar atë në provat shkresore të momentit të largimit nga puna ose përpara këtij momenti.
Del se deri në largimin tim nga puna nuk ishte formuluar asnjë shkak për largimin tim nga puna, e për pasojë dalja e gjykatës tej fakteve e provave duke bërë interpretime të pambështetura në prova e në ligj, e bën që vendimi të mos jetë në përputhje me ligjin dhe duhet të ndryshohet.
- Gjykata në pjesën arsyetuese të vendimit i referohet një vendimi tjetër procesi gjyqësor i të cilit ka filluar muaj më vonë në krahasim me procesin objekt ankimi dhe nuk kishte asnjë provë që kishte lidhje me kohën kur jam larguar nga puna.
- Gjykata e ka paragjykuar procesin dhe nuk është mbështetur në provat në të cilat kishte në dispozicion. Proceduralisht është i pakuptueshëm deklarimi se për të zgjidhur kontratën e punës ekzistonin shkaqe të justifikuara por të cilat nuk janë përdorur nga i padituri për largimin nga puna.
- Ligjërisht në momentin që unë paditësi Adriatik Kaja jam larguar nga puna pa asnjë motiv dhe pretendim nga punëdhënësi dhe mbi të gjitha pa asnjë vërejtje dhe masë nga ky i fundit, Kodi i Punës më jep mua të drejtë.
Proceduralisht gjykata ka vepruar gabim dhe nuk mund të trajtonte një çështje e cila është në gjykim dhe nuk ka asnjë vendim përfundimtar.
- Nga ana formale ligjore nëse gjykata do të konstatonte apo të konsideronte se ky procesi gjyqësor ndaj vendimit të të cilit unë po ankohem ishte i lidhur pazgjidhmërisht me atë të një procesi tjetër, minimalisht duhet të zgjidhte ndërmjet pikave të mëposhtme: Pezullimin e gjykimit në përputhje me nenin 297 K.Pr.Civile pika “a”-çështja nuk mund

të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër civile; Të mos merrte në konsideratë procesin civil tjetër, i cili filloi pas procesit të zgjidhjes së kontratës së punës.

- Gjykatat në veprimin e tyre jo vetëm e kanë paragjykuar çështjen, por është rreshtuar hapur me njëren palë, pasi:
- Për të kuptuar pathemelësinë e interpretimeve të gjykatave të të dy shkallëve mjafton të shtroj pyetjen: Nëse procesi gjyqësor tjetër në të cilin mbështeten gjykatat ku pretendohet dëmi i kryer do të përfundonte me një vendim përfundimtar të rrëzimit të padisë së Komunitetit Mysliman, Myftinia Durrës, a mund të qëndrojë në këmbë vendimi mbi rrëzimin e kërkesës për pagesën për largim të menjëhershëm dhe pa shkak nga puna kur provohet se shkak nuk qëndron? Përse largimi im nga puna nuk është bërë me një motivacion nëse ky do të kishte qenë në momentin e largimit tim nga puna?
- Gjykata e Apelit Durrës në mënyrë absurde ka dhënë arsyetime në kundërshtim me ligjin (K.Pr.Civile) dhe problemi i cili duhet të trajtohet dhe zgjidhur është nëse si provë për të provuar shkakun konsiderohet vendimi i një procesi gjyqësor në vazhdim apo vendimi përfundimtar i konfliktit gjyqësor?
Formalisht unë i qëndroj mendimit se si provë mund të konsiderohet vetëm një vendim gjyqësor i cili ka përfunduar dhe nuk mund të ndryshojë më (është shteruar rruga gjyqësore). Në rast të kundërt do të jemi përpara vendimeve absurde dhe të pambështetura në prova dhe ligj nëse vendimi gjyqësor ku mbështetet gjykata do të ndryshonte duke ndryshuar edhe kahun e të drejtës. Pra përfundimisht do të ishim përpara një vendimi qartazi të padrejtë.

Rekursi i palës së paditur Komuniteti Myslyman-Myftinia Durrës.

- Vendimi i Gjykatës së Apelit është dhënë në shkelje të hapur të ligjit.
- Gjykata e Apelit Durrës ka shkelur nenin 472 të K.Pr.Civile.
- Gjykata e Apelit Durrës ka shkelur nenin 467 germa “ç” “e” të K.Pr.Civile pasi vendimi nuk përmban arsyetimet ku bazohet ankimi.
- Në Gjykatën e Apelit çështja është gjykuar në mungesën tonë, pa pasur dijeni për zhvillimin e kësaj çështje. Nuk ka ardhur asnjë shpallje në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës, 10 ditë para se të zhvillohej gjykimi, çka do të thotë se ne nuk jemi njoftuar sipas detyrimit ligjor të nenit 460 K.Pr.Civile. Gjykata ka shkelur nenin 472, pika “b” të K.Pr.Civile. Shpalljet e ardhura në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës për proceset gjyqësore të datës 30.03.2015 nuk e kanë pasur të afishuar këtë proces gjyqësor. Për rrjedhojë, ne si palë nuk jemi njoftuar sipas rregullit të përcaktuar në nenin 406 K.Pr.Civile.
- Në kërkesë padinë e paditësit nuk kanë qenë fare objekt kërkimi dëmshpërblimet që i ka dhënë Gjykata e Apelit Durrës. Në objektin e kërkesë padisë nuk ka pasur kërkim për shpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në shkelje të procedurës të procedurës dhe as shpërblimin për zgjidhje të kontratës së punës për shkelje të afatit tre mujor. Kërkimi i paditësit për dëmshpërblim ka qenë vetëm në pikën dy të objektit të padisë “Detyrimin e palës së paditur të më paguaj dëmshpërblimin sa paga e një viti, për vjetërsinë në punë dhe për pushimet vjetore”. Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka rrëzuar kërkesë padinë, ndërsa Gjykata e Apelit Durrës në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të K.Pr.Civile është shprehur tej kërkimit të paditësit, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë pjesërisht.

- Gjykata e Apelit Durrës ka vepruar në kundërshtim me nenin 459 K.Pr.Civile, kërkesat dhe pretendimet që ai ka paraqitur në arsyetim në Gjykatën e Shkallës së Parë nuk janë asnjëra të parashtruara në kërkesën ankimore të tij që na është komunikuar më datë 28.03.2013.
- Kjo kërkesë ankimore është e shkurtuar dhe nuk përmban asnjë arsyetim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në ankim citohet se shkaqet do të paraqiteshin më vonë. Në nuk na është komunikuar asnjë ankim i arsyetuar më vonë me shkaqet e ankimit. Nëse shkaqet janë të parashtruara nga ana e palës paditëse para gjykatës së apelit tej asaj çfarë është parashtruar në kërkesën ankimore, Gjykata e Apelit Durrës ishte e detyruar të na komunikonte ne ankimin e plotë që të njiheshim me shkaqet e ankimit dhe të mbanim qëndrimin tonë.
- Madje gjykata konform nenit 455, pika “b” K.Pr.Civile duhet të kthente ankimin dhe jo të bënte shqyrtimin e çështjes pasi kërkesa ankimore e palës paditëse nuk plotëson kërkesat e nenit 454 K.Pr.Civile. Konform rregullave për njoftimin e ankimit duhet që ne si palë e paditur të na njoftohej arsyetimi i ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.
- Gjykata e Apelit Durrës pranon arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se i padituri ka zgjidhur me të drejtë kontratën punës në mënyrë të menjëhershme sepse në arkën e Myftinisë së Durrësit, që mbante paditësi, mungonin vlera të mëdha monetare.
- Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2014-3322 (906), datë 11.12.2014, të formës së prerë, ka vendosur detyrimin e Adriatik Kaja dhe Ilir Vokshi tu kthejnë Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Myftinia e Durrësit, shumat 10.000 euro, 1.274.000 lekë dhe 17.500 euro që kanë përvetësuar pa të drejtë.
- A mund të respektonte afatin 3 muajor të njoftimit i padituri në këto kushte dhe të mbante edhe 3 muaj të tjera në punë paditësin kur në arkë mungonin këto vlera ? Nëse gjykata si institucion apo qoftë edhe ndonjë institucion tjetër shtetëror do të ishte në të njëjtat kushte si Komuniteti Myslyman i Shqipërisë, Myftinia e Durrësit, çfarë do të bënte gjykata apo institucioni nëse financierit do t'i mungonin në arkë këto vlera monetare ? Do ta mbante në punë edhe 3 muaj të tjerë për të zbatuar afatin tre muajor apo do ta largonte menjëherë nga puna.
Interpretimi që jep Gjykata Apelit Durrës, pavarësisht se provohet se mungojnë këto vlera monetare dhe përgjegjësia ka qenë e paditësit për to, përsëri Komuniteti Myslyman i Shqipërisë, Myftinia e Durrësit duhet ta mbante edhe tre muaj të tjerë në punë, është tërësisht në kundërshtim me nenin 153 K.Punës.
- Largimi nga puna është bërë i menjëhershëm dhe tërësisht për shkaqe të justifikuara, për shkelje të rëndë të kontratës nga paditësi, shkelje e argumentuar me vendimin nr. 10-2014-3322 (906), datë 11.12.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës. Gjykata e Apelit Durrës ka qenë në dijeni të këtij vendimi, pasi ky vendim është online në faqen e saj zyrtare. Ndërsa në dosjen gjyqësore ka qenë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, që ngarkonte me përgjegjësi Adriatik Kaja dhe Ilir Vokshi për këto vlera monetare.
- Gjykata e Apelit Durrës pranon se jemi para rastit kur janë shkelur rëndë detyrimet kontraktuale nga paditësi, pra pranon që nuk mund të vazhdohej marrëdhënia e punës nga ana jonë, e megjithatë, na ngarkon me përgjegjësi duke na detyruar me dëmshpërblim me tre muaj pagë.
- Ligji nuk parashikon të drejtën e njoftimit tre muaj para në rastin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës dhe detyrimisht nuk ka as të drejtë pala të marr dëmshpërblim për këtë shkak.

- Gjykata e Apelit Durrës ka zbatuar keq ligjin kur i referohet nenit 143 K.Punës pasi nuk jemi para këtij rasti të zgjidhjes me procedurë normale të kontratës së punës. Qëllimisht ligjvënësi ka përcaktuar një mënyrë specifike të zgjidhjes së kontratës së punës me procedurë të përshpejtuar që e përcakton neni 153 K.Punës. Gjykata nuk i është referuar fare këtij rasti.
- Edhe në lidhje me njoftimin prej 72 orësh për të cilin gjykata na ka ngarkuar me përgjegjësi me dëmshpërblimin me dy paga mujore, kjo e drejtë për dëmshpërblim është në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës në procedurë normale dhe jo në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës për shkaqe të rënda siç është mungesa e vlerave monetare. Nëse do të zbatoheshin gjithë këto përcaktime ligjore për respektimi të afateve, referuar pozicionit delikat të punës që ka pasur paditësi, punëdhënësi rrezikonte të kishte pasojat edhe më të rënda pasi paditësi kishte në duar vlerat monetare të punëdhënësit.
- Mendojmë se neni 153 dhe 154 K.Punës përkojnë tërësisht me situatën konkrete. Madje, me vendimin e formës së prerë tashmë është provuar pika 2 e nenit 154 K.Punës pasi Adriatik Kaja është urdhëruar nga gjykata të zhëmbtojë dëmin që i ka shkaktuar Komunitetit Myslyman të Shqipërisë, Myftinia e Durrësit.
- Punëdhënësi, ka mbi tre vjet nga momenti që është provuar gjyqësisht në gjykatën e shkallës së parë Durrës me vendimin nr. 300, datë 06.02.2012, lënë në fuqi me vendimin nr. 10-2014-3322 (906), datë 11.12.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës, akoma nuk ka arritur të marrë shumat që i mungojnë për faj të punëmarrësit dhe që janë në vlerë të konsiderueshme.
Aktualisht jemi në fazën e ekzekutimit të vendimit, proces i cili gjithashtu ka hasur vështirësi të shumta për shkak të manovrimeve të paditësit Adriatik Kaja, i cili ka marrë kredi të pajustificuar për të na vështirësuar në kthimin e shumave që i kemi fituar me vendim gjykatë.
Tashmë me vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës detyrohem të paguajmë dëmshpërblimet për punëmarrësin që ka shkaktuar gjithë këto humbje.

II. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

13. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, (*në vijim Kolegji*), referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, çmon se në rekursin e paraqitur nga pala e paditur ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*në vijim KPC*), të cilat, bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

14. Paraprakisht vlen të evidentohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar KPC me ligjin nr. 44/2021, botuar në fletoren zyrtare në datën 14 Maj 2021 dhe që kanë hyrë në fuqi në datën 29 Maj 2021. Në nenin 32 të ligjit nr. 44/2021, mbi dispozitat tranzitore parashikohet se; “... 2.Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”. Në rastin e rekurseve të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre.

Në referim të ligjit të sipërcituar rezulton të ketë ndryshuar edhe mënyra e operimit të Kolegjit Civil, në atë kuptim që parimisht shqyrtimi i rekursit kryhet mbi bazë dokumentash nga trupi gjyqësor në dhomë këshillimi, pasi më herët relatori i çështjes ka vendosur datën dhe orën e

gjkimit të saj.

Përjashtimisht, Kolegji vendos të kalojë çështjen në seancë dëgjimore në prani të palëve vetëm kur kolegji vlerëson se çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; si dhe kur nisur nga problematikat e parashtruara apo për shkak të kompleksitetit të çështjes është e domosdoshme dëgjimi i palëve. Në çdo rast, referuar ndryshimeve që ka pësuar KPC në nenin 485 të tij, në dhomë këshillimi apo në seancë dëgjimore, Kolegji ka të drejtë të disponojë në një nga mënyrat e caktuara në këtë dispozitë. Në këtë kuptim e referuar nenit 32 të ligjit nr. 44/2021, pavarësisht kohës së regjistrimit të rekursit, Kolegji, sa i takon formimit të trupit gjykues, procedurës së gjykimit si dhe mënyrës sesi disponon i referohet dispozitave që janë aktualisht në fuqi.

15. Kolegji Civil vlerëson se, rekursi i paraqitur nga pala e paditur Komuniteti Myslyman-Myftinia Durrës, përmban rastet e parashikuara në ligj, prandaj si i tillë duhet të pranohet, ndërsa rekursi i palës paditëse Adriatik Kaja nuk është i bazuar në ligj e për rrjedhojë nuk duhet të pranohet.

Kolegji vlerëson se ndryshimi i vendimit të shkallës së parë nga gjykata e apelit është i pabazuar në ligj e për rrjedhojë ai duhet të ndryshohet e të lihet në fuqi vendimi i shkallës së parë Durrës. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit vlerësohet se, paditësi me veprimet e tij ka shkelur me faj të rëndë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga kontrata e punës dhe që kanë të bëjnë me administrimin e vlerave materiale dhe monetare të palës së paditur. Këto shkelje janë konstatuar nga kontrollet e ushtruara nga pala e paditur dhe mjafton ky fakt për të arritur në konkluzionin se me veprimet e tij paditësi ka kryer shkelje të tilla të cilat shkelin parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës. Në këto kushte nuk mund ti kërkohet palës së paditur të vazhdojë marrëdhënia kontraktuale e punës me palën paditëse apo shpërblimi për shkak të ndërprerjes së kësaj marrëdhënie për shkak se kjo ndërprerje është e justifikuar konform nenit 153 të Kodit të Punës i cili parashikon se: *“Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*

Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit”.

16. Lidhur me disponimin e gjykatës së apelit sa i takon respektimit të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës, Kolegji vlerëson të drejtë pretendimin e palës së paditur në rekurs se, në objektin e kërkesë padisë nuk ka pasur kërkim për shpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës për shkelje të procedurës të dhe as shpërblimin për zgjidhje të kontratës së punës për shkelje të afatit. Rezulton e vërtetë se pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesë me objekt : *“Detyrimin e palës së paditur të më paguaj dëmshpërblimin sa paga e një viti, për vjetërsinë në punë dhe për pushimet vjetore”*, kërkim që është rrëzuar edhe nga gjykata e apelit, ndërkohë që lidhur me disponimet e tjera rezulton se Gjykata e Apelit ka dalë tej kërkimeve të palës paditëse.

17. Kolegji çmon se pretendimet e ngritura në rekurs nga pala paditëse nuk qëndrojnë për të gjitha arsyetimet sa më sipër.

18. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Kolegji arrin në konkluzionin se, rekursi i paraqitur nga pala e paditur Komuniteti Myslyman-Myftinia Durrës,

është i bazuar në ligj, prandaj si rrjedhojë ai duhet të pranohet, ndërsa rekursi i palës paditëse Adriatik Kaja nuk është i bazuar në ligj e për rrjedhojë nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/b,
të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 10-2015-698 (278), datë 30.03.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr.11-2013-669 (343), datë 07.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.